REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 715/20
Datë/Datum. 06.10.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Kastrati	28.09.2020	06.10.2020	715/20
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.09.2020, OE "IT Market SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 715/20, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Vendosja e kamerave dhe mirmbajtja e tyre në Qytetin e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-2166-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 290,000.00€.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 64 - Dëshmitë e kërkesave
Neni 66 - Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69 - Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me date 12.09.2020 kemi parashtruar kerkese per rishqyrtim, me date 17.09.2020, kemi marrë pergjigje nga AK.
Ne pergjigjen e AK, nuk eshte specifikuar asgje edhe pse ne i kemi kundershtuar dhe arsyetuar pikat per te cilat jemi eliminuar.
Ne vijim pike per pike po ju ofrojme argumente se ne jemi te pergjegishem dhp jemi OE ofertues me cmimin

me te lire.

3.1 Projektet e natyrës se kontratës: Projektet nuk janë te natyrës se kontratës.
Ne dosje te tenderit e kemi preantuar listen e projekteve, dhe te gjitha projektete ne ate liste jane te natyres se kontrates, jane te gjitha projeketet te kane te bejne me teknoloji te informacionit.
Deshmi 1: Lista e kontratave dhe referencave

3.2 Menaxheri i projektit dhe 3.3 Eksperti i rrjetave kompjuterike - Nuk eshte percaktuar personi me ndonje vendim apo marreveshje per keto dy pozita. Te dokumentacioni i stafit jane dokumentet per 4 persona: Besjan Kurtishi (Master of IT and Management), Gazmir Hapqiu (Baqelor I Kriminalistikes), Rudina Muharemi (Baqelor i Inxhinierise elektrike) dhe Valmir Krasniqi (Baqelor i shkencave kompjuterike).
Ne ne tender i kemi prezantuar CV edhe referencat e stafit, AK me kete rast, ne vend se te kerkoje sqarime se cili prej stafit tone eshte menagjer i projektit, aina eliminon edhe pse te gjitha cv diplomat kane qene te dorezuar me oferte.

3.5 Pesë (5) teknik te implementimit - Mungojnë CV-te per te giithe tekniket e implementimit kopjet e diptomave dhe janë paraqitur vetëm 4 (katër) kontrata pune për kohe te Pacaktuar.
Ne listen e stafit, ne i kemi preantuar stafin, ne ate pike jane te jitha CV diploma per stafin e kerkuar sipas kerkeses se AK.
Deshmi 2: Stafi,

3.6 Lista e detajuar e produkteve qe do te liferohen - Mungon nënshkrimi dhe vula e OE-së në listën e detajuar te produkteve.
Nuk e kemi te qarte se çfar shkelje perben nese dokumenti ekziston, dosja eshte derguar ne menyre elektronike,
Deshmi 3: Lista e produkteve,

Kerkojme nga organi shqyrtues i prokurimit qe ankesen tone ta aprovoje si te bazuar dhe lenden ta kthej ne rivleresim, pasi qe i plotesojme te giitha kekesat e kerkuara ne dosje te tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat

Kërkes 1.
Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 430.000,00 €

Kërkesa 2
a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri I projektit I cili duhet të jetë ingjinjer I diplomuar I elektros drejtimi TI ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion
b. Një ekspert te analizimit te imazheve dhe bazë të të dhënave me pervojë pune min. 5 vjeqare në këtë lëmi.
c. Një ekspert te rrjetave kompjuterike
d. Pese teknik te implementimit te kamerave

Kërkesa 3
a. Autorizimi i prodhuesit ose perfaqesuest te autorizuar per Kosove per kamera dhe UPS

Kerkesa 4
a. Lista e detajuar e produkteve qe do te liferohen, perfshi numrin serik ose shenjen identifikuese te secilit produkt

Dëshmia dokumentare

Dëshmia 1
Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve.

Dëshmia 2
a. Nën pikën a:
1. Projekt Menaxheri
• CV
• Kopjet e diplomave universitare
Master në Shkenca Kompjuterike ose Sisteme të Informacionit ose Menaxhment .
• Kopjet e çertifikatave
- Menaxhim projektesh nga ITIL 4 Managing Professional ose CMI - Chartered Management Institute ose Prince2 (Projects IN Controlled Environment).
- Profesionist e i e çertifikuar për Dizajnim të Zgjidhjeve Intelegjente Biznisore ose Intelegjences Artificiale.
• Kontrata e punës (e vlefshme) ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt.

b. Nën pikën b:
Një ekspert analizimit te imazheve dhe bazë të të dhënave
• CV
• Kopjet e diplomave universitare
- Master në Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Kompjuterike ose Sisteme te Informacionit.
• Kopjet e çertifikatave
- Certifikate rreth analizimit te imazheve nga prodhues me renome boterore
- Specialist e i e çertifikuar për implementim dhe mirëmbajtje të bazave të të dhënave SQL.
• Kontrata e punës (e vlefshme) ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt.

c. Nën pikën c:
Një ekspert te rrjetave kompjuterike
• CV
• Kopjet e diplomave universitare
- Baqellor në Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Kompjuterike.
• Kontrata e punës (e vlefshme) ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt.

d. Nën pikën d:
Pese teknik te implementimit te kamerave
• CV

• Kopjet e diplomave shkollore
- Kopja e diplomes se shkolles se mesme ose certifikim CCNA ose ekuivalente per rrjeta.
• Kontrata e punës (e vlefshme) ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt. .

Dëshmia 3
Autorizim nga prodhuesi ose perfaqesuesi i autorizuar i prodhuesit ne Kosove se jeni i autorizuar per shitje (origjinal ose kopje).

Ne autorizim perveq tjerash duhet te shenohet edhe te dhenat e Autoritetit Kontraktues, Titulli i Kontrates dhe nr i prokurimit.

Autorizimi duhet te kete te gjitha informata per verifikim Numri telefonit,emaili adresa etj.

Deshmia 4
a. Lista e detajuar (bill of quantities) e produkteve qe do te liferohen, perfshi numrin serik ose shenjen identifikuese te secilit produkt, e nenshkruar dhe vulosour nga Operatori Ekonomik

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

3.Grup i Operatorëve Ekonomik IT MARKET SH.P.K.; Cacttus Sh.a. i mungojn; 2.Grupi i OE: "IT Market" SH.P.K – Prizren dhe "Cactus" Sh.A. – Prishtine:

3.1 Projektet e natyrës se kontratës: Projektet nuk janë te natyrës se kontratës.

3.2 Menaxheri i projektit dhe 3.3 Eksperti i rrjetave kompjuterike – Nuk eshte përcaktuar personi me ndonjë vendim apo marrëveshje per këto dy pozita. Te dokumentacioni i stafit janë dokumentet per 4 persona: Besjan Kurtishi (Master of IT and Management), Gazmir Hapqiu (Baqelor I Kriminalistikes), Rudina Muharemi (Baqelor i Inxhinierise elektrike) dhe Valmir Krasniqi (Baqelor i shkencave kompjuterike).
3.4 Eksperti i analizave te imazheve – Sipas kërkesave te tenderit kërkohet grada Master ndërsa personi i cekur (Veton Shala) e ka gradën Baqelor i Shkencave te Inxhinierisë Kompjuterike. Po ashtu, për personin e lartcekur mungon Kontrata e punës ose e kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt.
3.5 Pesë (5) teknik te implementimit – Mungojnë CV-te per te gjithë tekniket e implementimit kopjet e diplomave dhe janë paraqitur vetëm 4 (katër) kontrata pune për kohe te pacaktuar.
3.6 Lista e detajuar e produkteve qe do te liferohen – Mungon nënshkrimi dhe vula e OE-së në listën e detajuar te produkteve.

Sipas komisioni vleresues ky tender anlohet sepse nuk kemi Oe te pergjegjshem.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "IT Market SH.P.K"- PRISHTINË

Pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bëjnë me disa nga arsyet e eliminimit të dhënë nga AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, të dërguar me datë 08.09.2020.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr.1
Lidhur me projektet e natyrës së kontratës, AK ka konstatuar se projektet e OE nuk janë të natyrës së kontratës.

Bazuar në listën e kontratave të paraqitura nga OE, kontratat janë të natyrës së njëjtë dhe janë brenda kodit të klasifikimit të fjalorit të përgjithshëm të prokurimit (FPP) që ka kërkuar AK. Ky kod në njoftimin për kontratë është 50000000-5 dhe si fushëveprim ka "Pajisjet për meremetim, mirëmbajtje dhe Instalim", gjë që nga lista e projekteve të dorëzuara nga OE, bazuar në kontrata, referenca dhe përshkrimet tjera, ky aktivitet i prokurimit ka natyrën e njëjtë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr.2
AK ka konstatuar se nuk janë përcaktuar personat me ndonjë vendim apo marrëveshje të veçantë për pozitat: Menaxher i projektit dhe Ekspert i rrjetave kompjuterike.

Lidhur me ndonjë marrëveshje apo vendim të veçantë për Menaxherin e Projektit dhe Ekspertin e rrjetave kompjuterike, në njoftimin për kontratë nuk është kërkuar ndonjë dëshmi e tillë dokumentare specifike.
Prandaj, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikën 39.8 të Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, ku AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit", nëse CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara dhe AK nuk mund të vendos.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr.3
AK ka konstatuar se për pesë teknik të implementimit – Mungojnë CV-të për të gjithë teknikët e implementimit kopjet e diplomave dhe janë paraqitur vetëm katër kontrata pune për kohë të pacaktuar.

Lidhur me stafin OE ka paraqitur CV-të dhe dokumente përcjellëse të 10 anëtarëve të stafit. Prandaj, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, ku AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit", nëse CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara dhe AK nuk mund të vendos.

Pra, meqenëse nuk ka qenë e qartë për komisionin e vlerësimit të AK-së, funksioni i secilit nga stafi i paraqitur në ofertën e OE, dhe nga AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk janë kërkuar dëshmi

dokumentare që të ketë një përcaktim të tillë, AK është e obliguar që të dërgojë kërkesë për sqarim të tenderit në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikën 39.8 të Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr.4
AK ka konstatuar se mungon nënshkrimi dhe vula e OE-së në listën e detajuar të produkteve. Konstatimi i tillë është i bazuar, ngase një dokument i tillë është kërkuar shprehimisht si dëshmi dokumentare në Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit. Pra për të qenë valid ky dokument, OE është dashur të veprojë njëjtë si tek "Aneks 2 – Deklarata nën betim"

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – "IT Market SH.P.K"-PRISHTINË